




shqiponja e re e iglit

është ajo e Lazios.

Futbollisti i Kombëtares Shqiptare vjen në Romë ku tifozët lacialë i ndryshojnë nofkën e nuk e quajnë më "skafisti". Tani ai është Eagle Tare, shqiponja.

Lajmi i transferimit të Igli Tares nga Bologna tek Lazio kishte kohë që qarkullonte. Me kalimin e ditëve, ndërsa presidenti i klubit të Lazios, Claudio Lotito, vazhdonte negociatat për blerjen, tifozët diskutonin nëpër forume ku kryesisht mbizotëronin dy rryma: ata që mezi prisnin "il corazziere di Valona" (apo lo scafista...) dhe të tjerë që e konsideronin të tepruar këtë interes për një lojtar 32-vjeçar. Një dëmtim i lehtë nuk lejoi që të debutonte në ndeshjen e parë të Lazios. Por që tani edhe tifozët lacialë shohin tek ai një premtim për ekipin. Emri i Igli Tares ka marrë që tani për ta formën e simbolit të ekipit, Eagle Tare.. I konsideruar nga të gjithë si "ambasadori i shqiptarëve në Itali" Igli ka ditur ta kryejë vërtet këtë rol duke ngritur shpesh zërin kundër episodeve të intolerancës ndaj shqiptarëve. Rasti më i fundit i solidarësisë së një kampioni të vërtetë për bashkatdhetarët e tij ishte ai i para dy muajve kur Igli Tare mbështeti i pari letrën e "Botës shqiptare" kundër qëndrimeve raciste ndaj shqiptarëve në Varese, letër që u botua në "Corriere della Sera" me firmat, mes të tjerëve edhe të personazheve të tjerë të njohur shqiptarë në Itali.



Shqiptari i Italisë - Mirëse-erdhe në Romë, Igli. Si të pritën në klubin e Lazios?

Igli Tare - Pritja ishte mjaft e thjeshtë. Skuadra ishte në fazë përgatitore dhe pritja ishte normale. Në këto raste nuk bëhen festa apo gosti. Më shumë bën efekt ndryshimi i ambientit dhe fakti që do të jetoj në një qytet të ri.

Thuhet që të ka kërkuar shprehimisht Delio Rossi, trajneri i Lazios. Ç'marrëdhënie ke zakonisht me trajnerët?

- Është e vërtetë që Delio Rossi ka ngulur këmbë që të më ketë në skuadër. Në Brescia dhe Bologna unë kam

patur trajner Mazzonen me të cilin kam patur marrëdhënie profesionale, asgjë më tepër se profesionale.

Deri para pak vitesh skuadra e Lazios ka patur nivele shumë të larta si në përbërje ashtu edhe në rezultate. Publiku lacial, në një farë mënyre i mësuar me kampionë, do të jetë më kerkues se ai i skuadrave të tjera ku ke luajtur?

- Pritja që më bënë kur kalova tek Lazio ishte shumë pozitive. Tani gjithçka varet nga paraqitja ime në fushën e lojës. Nga loja ime, por edhe nga ajo e skuadrës në përgjithësi. Syn-

imi ynë është sigurisht që t'i kënaqim tifozët tanë.


Në skuadrën e Lazios tani për tani ti je i vetmi lojtar që dallohet në lojën ajrore. Mendon se kjo do të të garantojë një vend si titullar?

- Kjo është vështirë të parashikohet. Vërtetë si titullar mund të ma garantojë vetëm loja që do të bëj dhe aftësitë që do të dëshmoj në fushë. E sidomos në javët e para të kampionatit.

Si i ke marrëdhëniet me kapitenin e Lazios, Paolo Di Canio? Gjatë një ndeshjeje vitin e kaluar, ti me fanellën e

Nga Giovanni Armillotta
historian sportiv

ekskluzive për
"Bota shqiptare"



Qysh 10 vjet më parë Besnik Dizdari, në një artikull historik të botuar në të përjavshmen e drejtuar nga unë "Lo Specchio" (Pisa, nr. 13, 15 korrik 1995), lajmëronte mbërritjen e lojtarëve shqiptarë në kampionatet e futbollit italian, duke përmendur Fortuzin, pionier të ardhjes së dytë, që gjatë atyre viteve luante në Brindisi; më pas foli për një italian në Shqipëri, portierin e Kombëtares shqiptare të vitit 1946 Xhakomino Pozeli (Giacomino Poselli), "që aq shumë i dha futbollit shqiptar dhe që u kthye në atdhe duke lënë pas keqardhjen e shokëve dhe të mbarë publikut". Do të ishte vërtet interesante të dihej - tashmë pas

ngakryeziutetare historieshkurtër e shqiptarëve në serie A

Llambi, shqiptari i parë Kampion i Italisë
Lushta ndër sulmuesit e huaj më të
mëdhenj të Juventusit

60 vjetësh - mbi jetën e Xhakomino Pozelit pas kthimit të tij në Itali: nëse vazhdoi të merret me futboll, nëse jeton akoma. Ka qenë italian i parë që ka fituar një titull ndërkombëtar futbollit pas Luftës II botërore!

Rreshtimi i futbollistëve shqiptar në vendin tim, në fakt, nuk ishte absolutisht një e re dhe shkrimi i sipërpërmendur "Buoni i rapporti sportivi italo-albanesi" vinte pas mëse gjysmë shekulli nga shqiptarët e parë të tësuar në Itali.

Kaluan thuhet 5 vjet dhe e përjavshmja shqiptare (sot revistë elegante e përmuajshme) e drejtuar nga Dizdari, "Futbolli Shqiptar", botoi në faqe të parë



Igli Tare
lindur në
Vlorë më 25
gusht 1973,
sulumues.
Debutimi në
Serien A më
28/012001:
Brescia-Milan
1-1 (java XVI)

Foto majtas Tare
gjatë Triangolare-s së
Fiuggit dhe në stërvit-
je krahas Behramit

EDICIONI	SKUADRA	SERIE	NDESHJE	GOLA
1996-97	Karlsruher SC (DE)	A	8	-
1997-98	Fortuna Düsseldorf (DE)	B	34	13
1998-99	Fortuna Düsseldorf (DE)	B	20	11
1999-00	Fortuna Düsseldorf (DE)	C	-	-
Ott. 1999	1. FC Kaiserslautern (DE)	A	22	4
2000-01	1. FC Kaiserslautern (DE)	A	4	-
Gen. 2001	Brescia	A	17	4
2001-02	Brescia	A	25	5
2002-03	Brescia	A	33	6
2003-04	Brescia	A	-	-
Ago. 2003	Bologna	A	29	6
2004-05	Bologna	A	26	5
2005-06	Lazio	A		

Skeda sportive e Igli Tares dhe e futbollistëve të tjerë në faqet 10-11 u përgatiti nga Giovanni Armillotta

Bolognas dhe ai me atë të Lazios, mbaj mend që patët fërkime.

- Kemi marrëdhënie normale kolegësh. Është përmendur në fakt shpesh zënka që kam patur me Di Canion në Bolonja por mund të them se nuk ka asnjë gjë përtej marrëdhënies time me të si me gjithë lojtarët e jerë të ekipit,

Në skuadrën e Lazios ka ardhur edhe kosovari Valon Behrami. Për të flitet shumë mirë. Ti si mendon?

- Valoni është shumë i ri dhe duhet të konfirmohet. Aftësitë dhe talentin i ka, i mbetet vetëm që të punojë sa më shumë.

Derbi Roma-Lazio është një ngjarje shumë e ndjekur këtu në kryeqytet dhe një ndeshje shumë e ndier. Thonë që edhe lojtarët më të ftohtë kanë emocione dhe se nuk është e lehtë të luash pa u përfshirë nga atmosfera e zjarrtë që krijohet. Si mendon se do të jetë derbi yt i parë?

- Natyrisht që derby hyn tek ngjarjet më të rëndësishme sportive në Itali. Nuk di ç'emocione provohen, ngaqë s'e kam përjetuar akoma. Por e pres, e di që do të

jetë diçka e veçantë.

Në internet ekziston një forum që quhet Lazonet ku tifozët shkëmbejnë ide dhe përshtypje mbi skuadrën e tyre të zemrës. Ky forum kundërshton idenë që është krijuar mbi tifozët e Lazios si racistë dhe ekstremistë të djathtë. Sipas teje iniciativa të tilla a mund të sjellin ndryshime në shkallët e stadiumeve?

- Tendencat e tifozëve nuk më interesojnë aspak. Unë dua që të gjykojmë nga loja që bëj dhe kaq. Të them të drejten nuk kam as kohë dhe as interes për t'u marrë me tematika të tilla.

Sa e ndjek kampionatin shqiptar?

Pak, me aq sa mundem. Unë luaj e stërvitem në të njëjtët ditë si edhe ata.

Sipas teje në kampionatin shqiptar atje talente që mund të arrijnë të luajnë në Serien A të kampionatit italian?

- Mendoj se tani për tani jo. Po të kishte patur padyshim që ndonjë skuadër italiane do të kishte treguar interes.

Ti ke qenë më parë me

skuadrën e Brescias dhe atje ke patur rastin të luash me një kampion si Roberto Baggio. Ke përfituar nga kjo përvojë?

- Të luash me Baggion është diçka e veçantë. Ai është një prej kampionëve më të mëdhenj të botës dhe kur rruga ime dhe rruga e tij profesionale u takuan, sigurisht që ka qenë një periudhë e rëndësishme për mua.

Nga Gjermania në Itali, nga Brescia në Bolonjë, nga Bolonja në Romë. E ke marrë Europën nga Veriu për të zbritur në "caput mundi" Si thua do të bëhet ky i fundit qyteti yt?

- Akoma nuk di ç'të them. Është mjaft herët, koha do ta tregojë. Sidoqoftë mu duhet të them se Roma më ka pëlqyer gjithnjë.

Je transferuar me gjithë familjen?

- Po. Jemi vendosur familjarisht në Romë. Kemi marrë një shtëpi në zonën e Cassias në të dalë të Romës.

Urime e siç thuhet mes lazialëve për të uruar fat: in becco all'aquila!

- Faleminderit.

i.cami



Shqiptari i kombëtares zvicerane në një skuadër me kapitenin e kuqezinjve

Mund të kishi qenë jo vetëm shokë skuadre në Itali, por edhe në përfaqësuesen shqiptare. Por Valon Behrami, kosovari kartela e të cilit është blerë nga Lazio, është shprehur se edhe pse ndihet kosovar dhe nuk do të donte të zhgënjente prindërit dhe miqtë e tij, ai do të zgjidhte Kombëtaren e Zvicrës, nëse ajo do të kualifikohet në Evropianin 2008. "Deri tani kam luajtur me të rinjtë e Zvicrës, por kjo nuk do të më pengojë të bëj zgjedhjen time në të ardhmen. Nëse Zvicra do të kualifikohet për në Evropianin 2008, atëherë nuk ka asnjë dyshim që do të zgjedh Zvicrën". Më pas futbollisti është shprehur edhe për rolin që do të ketë në mesfushën e Lazios, ose për atë që ai do të bëjë më mirë: "Nuk jam unë ai që bëj diferencën në fushën e lojës". Këto janë fjalët e futbollistit, gjysma e kartonit të pronësisë së tij ka kushtuar 2 milionë e 800 mijë euro. Por profesioni i Behramit, nuk është i rëndomtë dhe ai mendon se duhet të tregohet sa më korrekt me stafin dhe sportdashësit: "E them këtë, sepse e kam provuar. Nuk jam unë ai që hyn në fushën e lojës dhe papritmas ndryshon gjithika. Te Xhenoa e kam vuajtur shumë aktivizimin e pjesshëm: e kuptoj që jam i ri, por secili ka karakteristikat e tij. Besoj se kam grintën e duhur, që mund t'i jap një shtysë më tepër skuadrës, që mund të avancoj shumë mirë nga krahët, që vrapoj dhe jap maksimumin gjatë gjithë lojës: këtë mund të garantoj unë. Por fantazistin, në kuptimin e mirëfilltë, nuk mund t'a bëj. Vitin e kaluar te Verona shënova tre gola, dy prej

të cilëve i shënova me këmbën e majtë, që nuk është këmba ime e preferuar, sepse dihet që unë përdor gjithmonë të djathtën". Ta shohësh kur vrapon në fushën e lojës dhe kur dëgjon komplimentet e Adriano Bianchini, një nga anëtarët e personelit që merret me rikuperimin e të dëmtuarve, kuptohet menjëherë se, Behrami ka një dëshirë shumë të madhe që të arrijë formën e tij maksimale. "Eh, Seria A është një eksperiencë e re. Me këtë nuk dua të them se kam frikë, por dua të jem i gatshëm për skuadrën sa më parë. Në Serinë B, të ndodhte të kishe edhe ndonjë ndeshje të lehtë, por tani gjëra të tilla as që mendohen. Kam patur disa momente të vështira, por kur u transferova te Verona, trajneri Fikadenti më ndihmoi shumë dhe më ktheu besimin në vetvete dhe për këtë e falënderoj atë". Ai më pas tregon edhe për jetën e tij, ku pranon se edhe pse në moshë të re, ka hasur shumë vështirësi. Behrami ishte ende fëmijë, kur babai i tij Ragipi dhe nëna e tij Halime, u detyruan të largoheshin nga Kosova për t'u vendosur më pas në Zvicër: "Isha katër vjeje dhe në ato kohë dukej qartë se konfliktet ishin të pashmangshme. Ne ishim një familje e madhe dhe dikush duhej të emigronte për të ndihmuar të tjerët ekonomikisht. Babai im filloi të punonte si shofer transporti dhe nëna ime punonte shpesh herë me orarë të zgjatura, jam shumë i lumtur që tani ajo nuk punon më dhe gjithashtu, jam krenar që falë punës dhe të ardhurave të mia, ajo tashmë rri në shtëpi."



fotografinë me ngjyra të Erion Bogdanit me titullin "Pas 48 vjetëve një shqiptar në Serie A: Bogdani" (nr. 39, 5 shkurt 2000). Akoma një tjetër vit dhe - për të mbështetur përshtypjen e mirë që po krijonte në Itali Bogdani, dhe shqiptarët e tjerë e legionit të huaj nëpër botë - "Futbolli Shqiptar" në nr. 75 të 9 shkurtit 2001, për të festuar debutimin në Serien A të Igli Tares (28 janar 2001: Brescia-Milan 1-1), vë në faqe të parë një fotografi me ngjyra katërkolonëshe të futboll-

listit në aksion. Por, për titullin "Igli Tare - i pesti i mohikanëve në Serie A!" do të kisha diçka për të thënë në lidhje me fjalën "i pesti".

Tarja vjen nga Partizani i Tiranës, ku ka fituar Kupën e Shqipërisë 1991 dhe 1993; ka qenë nënkampion i Ballkanit më 1990-n me Kombëtaren shqiptare "Under 18". Pas një pesëvjeçari në Gjermani 1996-2001, ka shkuar në skuadrën e Brescias. Pas javës II të Kampionatit 2001-02, më 9 shtator

2001, ai ishte i pari në renditjen e golashënuesve më të mirë të Serisë A, me katër gola: Brescia-Milan 2-2 (dy gola të Tares) dhe Torino-Brescia 1-3 (dy gola të tjerë të tij). Tashmë Tare po bëhet edhe futbollisti me më shumë ndeshje në Kombëtaren shqiptare. Për edicionin 2005-06, Tare do të luajë me Lazion dhe Bogdani me Sienën.

Tani le të kthehemi mbrapa në kohë në kërkim të futbollistëve shqiptarë të të shkruarës.

vijon në faqen 10



Riza Lushta (1916-97, foto majtas), lindur në Mitrovicë, sulmues; i ardhur në Serie A nga Sportklub Tirana; Kampion i Shqipërisë në vitet 1934, 1936, 1937 dhe 1939; fitues i Kupës së Shqipërisë 1938-39. Debutimi në Serien A më 07/01/1940: Bari-Venezia 3-0 (java XIV)

EDICIONI	SKUADRA	SERIE	NDESHJE	GOLA
1939-40	Bari	A	16	3
1940-41	Juventus	A	26	10
1941-42	Juventus	A	28	15
1942-43	Juventus	A	26	17
1944	Juventus	CB	5	5
1945-46	Napoli	A	27	6
1946-47	Alessandria	A	26	13
1947-48	Alessandria	A	21	4
1948-49	Cannes	A	?	?
1949-50	Cannes	B	?	?
1950-51	Cannes	B	?	?
1951-52	Siena	C	-	-
1952-53	Forlì	D	21	-
1953-54	Rapallo	D	22	-



Naim Kryeziu (1918, foto majtas), lindur në Gjakovë, sulmues; i ardhur nga Sportklub Tirana; Kampion i Shqipërisë në vitin 1939; fitues i Kupës së Shqipërisë 1938-39. Debutimi në Serien A më 10/03/1940: Roma-Bari 4-2 (java XXII, në skuadrën e Barit luante Lushta: ishte i pari "derby" shqiptar; Lushta shënon për Barin golin e barazimit 1-1 që ishte edhe goli i tij i parë)

EDICIONI	SKUADRA	SERIE	NDESHJE	GOLA
1939-40	Roma	A	5	-
1940-41	Roma	A	20	3
1941-42	Roma	A	23	6
1942-43	Roma	A	9	-
1945-46	Roma	A	33	11
1946-47	Roma	A	32	6
1947-48	Napoli	A	33	9
1948-49	Napoli	B	35	6
1949-50	Napoli	B	40	9
1950-51	Napoli	A	37	11
1951-52	Napoli	A	23	5
1952-53	Napoli	A	-	-
1953-54	Turris	D	22	-

histori
e shkurtër
e shqiptarëve
nëserieA

vijon nga faqja 9

Kryeziu, Lushta e Boriçi

Naim Kryeziu dhe Riza Lushta kanë qenë, padyshim, futbollistët shqiptarë më të mëdhenj nga mesi i viteve Tridhjetë deri në gjysmën e dytë të viteve Dyzet. Ata bënë emër jo vetëm me titullin e Kampionit të Italisë fituar nga Kryeziu me Romën më 14 qeshor 1942, apo me Kupën e Italisë (28 qershor 1942) fituar nga Lushta, i vetëm kundër Milanos (kështu quhej atëherë) falë tre golave të tij në përsëritjen e ndeshjes në Torino (4-1) pas rezultatit 1-1 të ndeshjes me gjithë shtesat në Milano, shtatë ditë më parë. Renditja më e mirë në Serien A ka qenë në edicionin 1942-43 kur arriti i treti me Juventusin.

Duhet kujtuar që në nëntor të vitit 1940, Lushta u thirr për stërvitje edhe nga Kombëtarja italiane, asokohe dy herë kampione e botës, për ndeshjen miqësore kundër Hungarisë të 1 dhjetorit (1-1); por Vitto-

rio Pozzo mori urdhër të mos e rreshtonte mes të thirrurve për arsye politike, duke qenë se Shqipëria ishte një vend në Bashkim Personal me Italinë në luftë.

Në vitin 1946 Ludovik 'Vik' Jakova, zëvendëstrajner i Kombëtares shqiptare të futbollit në krijim e sipër, erdhi dy herë në Itali për të bindur Kryeziun dhe Lushtën të luanin në edicionin e VIII të Kampionatit Ballkanik. Për detyrime kontraktuale me Romën e Napolin dy lojtarët nuk mundën të pranenin, megjithatë Kombëtarja shqiptare e fitoi manifestimin e parë europian mes Kombëtareve të pasluftës. Dy shqiptarët kanë qenë në fushë deri në vitin 1954.

Lushta fitoi kreun e renditjes së golashënuesve të Kupës së Italisë 1941-42 me tetë gola (shënoi edhe një tjetër gol për Juventusin në Kupën e Italisë 1942-43); po në vitin 1942 u rendit i katërti ndër golashënuesit më të mirë dhe i pari ndër të huajt. Kam zbuluar që Lushta ka shënuar edhe 5 gola të tjerë në po aq ndeshje gjatë

Kampionatit të luftës, 1944, gola që janë njësoj të vlefshëm për statistikat e Juventusit (shiko: <http://www.juventusstory.it/>).

Lushta me Juventusin ka shënuar, gjithsej, 56 gola në 95 ndeshje: 42 në Serien A, 5 në turneun e luftës dhe 9 në Kupën e Italisë. Mesatarja e lartë e shënimit, (0,589 gola për ndeshje) e rendit atë në vend të tretë mes gjithë sulmuesve të huaj të Juventusit që kanë shënuar më shumë se 50 gola, dhe në vend të katërt në renditjen absolute (shih tabelën)

LOJTARI	KOMBESIA	GOLA	NDESHJE	MESATARE
P. Pastore	Itali	55	66	0,833
O.E. Sivori	Argentinë	171	257	0,665
J. Hansen	Danimarkë	124	189	0,656
R. LUSHTA	Shqipëri	56	95	0,589
J.W. Charles	Uells	105	182	0,577
R. Baggio	Itali	115	200	0,575
D. Trezeguet	Francë	93	163	0,571
G. Gabetto	Itali	102	191	0,534
F. Inzaghi	Itali	87	165	0,527
F.P. Borell II	Itali	160	307	0,521

Emrin e Lushtës mban sot stadiumi i Mitrovicës.

Ndërsa Kryeziu u bë trajner profesionist i kategorisë së parë: zëvendëstrajner i Romës nga viti 1962 deri më 1965 dhe titullar për gjashtë muaj në edicionin 1963-64, para se të mbërrinte spanjollit Luis Miró; periudhë e mjaftueshme që Kryeziu të përgatiste skuadrën që do të fitonte Kupën e Italisë. Sot Kryeziu është në Panteonin e lojtarëve më të famshëm të Romës. Emrin e tij mban sot stadiumi i Gjakovës.

Shqiptari i tretë i atyre viteve ka qenë i madhi Loro Boriçi, shok skuadre i lacialit Silvio Piola, kampion bote. Në vitin 1946 Boriçi ishte kapiteni i Shqipërisë që fitoi Kampionatin Ballkanik. Kombëtarja drejtohej nga trajneri Ljubisa Brocic, i cili në 1957-58 fitoi Serien A me Juventusin. Për Boriçin nuk po zgjatëm pasi ai është i famshëm nga Roma deri në Pekin ku ka qenë edhe europiani i parë që ka drejtuar Kombëtaren kineze.

Bota shqiptare

GAZETA E SHQIPTARËVE NË ITALI

ABONIMI PËR NJË VIT
(22 NUMRA)

35 EURO

pa asnjë shpenzim të mëtejshëm, gazeta të mbërrin drejt e në shtëpi

pagesa kryhet

pranë çdo poste italiane

nëpërmjet

derdhjes në llogarinë postare

(conto corrente postale) nr. 16831018 në favor të (intestato a)

BOTA SHQIPTARE

Viale Tito Livio 8, 00136 Roma

TEL 06-57289240 - FAX 06-45435768 - CEL. 339-6426836

abonime@botashqiptare.net

Agenzia Italo-Shqiptare

**ALKO TOUR
&
MARCO POLO**

Roma - Tirana

€99

bus + trageti + taksa imbarkimi

Çdo te premte autobusi nisat nga stacioni Tiburtina
ora 14:30

Per informim me te hollësishem mund te telefononi:

06 21703608 - 06 2147721

e-mail: alko@hotmail.it



Sllave Llambi (1919-85 foto majtas), lindur në Tiranë, i lirë; vjen nga Sportklub Tirana; Kampion i Shqipërisë: me Tiranën në vitet 1937 dhe 1939; me Partizanin në vitet 1948 dhe 1949; Fitues i Kupës së Shqipërisë me Partizanin në vitet 1948 dhe 1949; fitues i Kampionatit VIII Ballkanik në vitin 1946. Debutimi në Kupën e Italisë Serie A/B më 13/09/1942: Fanfulla-Savona 6-1 (Turni I)

EDICIONI	SKUADRA	SERIE	NDESHJE	GOLA
1940	Brindisi	C	-	-
1940-41	Bologna	A	-	-
1941-42	Ambrosiana-Inter	A	-	-
1942-43	Fanfulla Lodi	B	27	-

Loro Boriçi (1922-84, foto djathtas), lindur në Shkodër, qendër-fushor; i ardhur nga Vllaznia Shkodër; Kampion i Shqipërisë: me Vllazninë në vitet 1940 dhe 1945; me Partizanin në vitet 1948 dhe 1949; Fitues i Kupës së Shqipërisë me Partizanin në vitet 1948 dhe 1949; fitues i Kampionatit VIII Ballkanik në vitin 1946 (kapiten).

EDICIONI	SKUADRA	SERIE	NDESHJE	GOLA
1941-42	Lazio	A	4	-
1942-43	Lazio	A	14	3

Rasti i çuditshëm" i Sllave Llambit

Sllave Llambi shpesh nuk përmendet si një nga futbollistët shqiptarë i Series A italiane, përpara Luftës II botërore.

Duke konsultuar "Almanacco Illustrato del Calcio 2005" të Paninit të Modenas, në fakt, arrihet në përfundimin se Llambi nuk ka luajtur asnjë ndeshje as me Bolonjën e as me Interin. Kështu, gjatë atyre dy edicioneve ai ka qenë një rezervë që nuk ka luajtur as edhe një ndeshje. Por, kujdes! Megjithatë rezervë, ishte me Bolonjën në edicionin 1940-41, ndaj edhe ka qenë pikërisht ai, Sllave Llambi, - akoma më herët se Kryeziu - i pari shqiptar Kampion i Italisë!!! Meqë quhesh Kampion i Italisë edhe nëse nuk ke luajtur në asnjë ndeshje, mjafton të jesh i pranishëm ndër grupin e lojtarëve të skuadrës kampione. Por jo vetëm kaq! Ai që - sipas Bimo Fakjes - "ka qenë centër-halfi më i mirë i Shqipërisë, e përkthyer në të sotmen, do të thotë mesfushori mbrojtës më universal", luajti me skuadrën Fanfulla të Lodit në Kupën e Italisë 1942-43 kupë e hapur ndaj të gjitha skuadrave të Series A dhe B (më 13 shtator: Fanfulla-Savona 6-1

dhe 20 shtator '42: Triestina-Fanfulla 3-0).

Për arsytet e mësipërme, në nder të madhësisë së tij dhe me lejen e mikut tim prej 20 vjetësh, Besnik Dizdari, do të propozoj që Sllave Llambi - në 20-vjetorin e vdekjes së tij - të futet "in honoris post mortem titulo" në grupin e gjashtë lojtarëve shqiptarë që kanë luajtur në Serien A të Kampionatit Italian të futbollit.


Kur u kthye në atdhe, Llambi ka qenë një nga protagonistët e Kombëtares në Kampionatin e Ballkanit 1946. Pas tre vjetësh ka qenë, ndoshta, i pari lojtar-trajner i një kombëtareje në botë; Shqipëria në Bukuresht (1-1), Varshavë (1-2) dhe Sofje (0-0).

Së fundi, në kujtim të përgatitjes së tij atletike të shumanshme dua të përmend edhe faktin që ai ka zënë vendin e gjashtë në Kërcimin së larti, me rekordin kombëtar 1,75 m në Kampionatet Ballkanike të Atletikës së Lehtë të viti 1938 në Beograd.

Pas këtyre kampioneve, u desh të kalonin mëse 50 vjet që në Serie A të të vinin dy shqiptarë të tjerë: Erjon Bogdani dhe Igli Tare.

Giovanni Armillotta

për "Bota shqiptare" ku ky artikull është botuar në italisht.



PËRFAQËSUESJA SHQIPTARE KA EKZISTUAR PARA THEMELIMIT TË FEDERATËS KOMBËTARE TË FUTBOLLIT?

Revista "Corriere dello Sport-Stadio" e sotme lind si një e përtremuajshme më 20 tetor 1924 në Bolonjë, nismë e një grupi të apasionuarish të kryesuar nga Leonardo Arpinati, figurë e fashizmit bolonjez, dhe nga Alberto Madel, aviator së bashku me D'Annunzion në sulmin ajror mbi Vjenë, e më parë qendër-sulmues i Interit. Në vitin 1927 shndërrohet në "Il Littoriale", dhe transferon selinë në Romë. Më 9 qershor 1944, thuajse një vit nga rënia e regjimit fashist, revista rrihet "Corriere dello sport" dhe në vitin 1977 bashkohet me bolonjezen "Stadio". Gjatë kërkimeve të mia mbi futbollin shqiptar, kam gjetur një artikull të shkurtër në

La Coppa dei Balcani

Rumunia b. Jugosllavia: 2 a 1

BUCAREST, 10

Gl'incontri per la disputa della Coppa dei Balcani a cui partecipano la Rumania, la Bulgaria, la Jugoslavia, la Grecia e l'Albania, hanno avuto il loro inizio colla partita delle rappresentative della Rumania e della Jugoslavia. La battaglia ebbe il suo svolgimento a Bucarest e terminò colla vittoria dei rumeni, i quali segnarono 2 goals contro 1 degli avversari. Il primo tempo si chiuse alla pari con 1 a 1.

"Il Littoriale", 11 ottobre 1929

fakti që edhe Shqipëria ishte e regjistruar, edhe pse nuk mori pjesë në Kampionat: tërheqja e një kombëtareje nga një turne ndërkombëtar nuk është ndonjë lajm edhe aq i bujshëm. Por vlera e jashtëzakonshme e zbulimit qëndron në faktin që Shqipëria, të paktën formalisht, kishte një skuadër Kombëtare në letër, akoma më herët se të formohej edhe vetë "Federata Shqiptare e Futbollit". Siç dihet nga të gjithë, data e krijimit të FShF është 6 qershor 1930, dhe regjistrimi i saj në FIFA është bërë në Kongresin e Stokholmës 12-16 qershor 1932; ndërsa UEFA u krijua në vitin 1954 dhe Shqipëria ka qenë një nga anëtarët themelues të saj. g.a.

AUTOTRASPORTI

ARTAN HOTI



itali -shqipëri - itali

shërbime transporti me kamionë shumëtonësh

2,2 tonë
(ose 13 m³,
ose 7-8 europallet)
VETËM
€ 1400 + IVA

AUTOTRASPORTATORE

Artan Hoti

Via Corsini, 6/4,
41100 MODENA

Tel 347-6662827

**Që sot e tutje hyrja në Itali për
turizëm, studime,
dhe punë të pavarur**

është më e lehtë.

**Falë fidejusionit dhe sigurimit
shëndetësor I CARE**

**nuk do të kesh më nevojë të tregosh
paratë apo të marrësh para me vete
për të garantuar mënyrën e jetesës në Itali
ose asistencën shëndetësore.**

I CARE: në Itali pa probleme.

Telefono në numrin 06 8741 0246

I Care